

SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" sh.p.k

VENDIMI I  
ASAMBLESE SE  
JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Sot me date 28.10.2000 (dymije), Shoqeria "New Paradise International" Sh.p.k, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer 43998/2000 ne Vicenza, date 12.09.2000, me Kod Fiskal 02862300247, e perfaqesuar nga administratori unik GIOVANNI PANNI, i cili ne baze te nenit 12 te Statutit te Shoqerise ka te drejte te kryeje cdo lloj veprimi per perfaqesimin e shoqerise ne marrjen e vendimeve te asamblese se zakonshme e te jashtezakonshme, si ortak e vetme e SHOQERISE "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk. e regjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane, Regjistrin Tregtar, me Vendimin Nr.13264/3 date 29.04.1999, me seli ne Tirane, rruga "Bab Rexha", Nr.31, me Nipt J72207013A, organizon mbledhjen e jashtezakonshme te Shoqerise "Di VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, me rend dite:

1.-Depozitim prane Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane te aktit te shitblerjes se kapitalit me Nr.4870 Rep., date 02.10.2000 te bere nga Noteri Z.GIOVANNI DI PIERDOMENICO, Noter ne Pescara-ITALI, me vlere 1.665.000 (njemiljon e gjashteqindgjashtedhjet e pesemije) dollare USD nga shoqeria "Di Vincenzo Estero" shpk, nga te cilat 700.000 (shtateqindmije) dollare USD jane paguar per blerjen totale te kapitalit te Shoqerise, ndersa 965.000 (nendeqindgjashtedhjetepesemije) dollare USD jane paguar per likuidimin e kredive qe "DI VINCENZO ESTERO" srl ka pasur ndaj "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, duke u bere ortak i vetem i kesaj shoqerie; shoqeria "New Paradise International" shpk.

2.-Kapitali i Shoqerise do te jete ne shumen 111.845.000 (njeqindnjemibedhjetmiljon e teteqindedyzetepesemije) leke..

3.-ADMINISTRATORET e Shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk do te jene te jashtem Z.ADRIAN DULAKU dhe Z.MATTEO SCALCO, te cilet vetem per shitjen e pallateve duhet te neneshkruajne te dy ne te njejten kohe.

4.Objekti i Shoqerise mbetet ajo e Shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk.

5.Afati i Shoqerise do te jete ai i percaktuar nga Shoqeria "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, deri ne 50 vjet.

6.Seli e Shoqerise do te ndryshohet nga adresa egzistuse "Bab Rexha", Nr.31 ne adresen : Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pall.27, shkalla 1, Ap.3, TIRANE. Ne perfundim te mbledhjes se jashtezakonshme, u vendos te miratohet sa siper dhe per neneshkrimin e kerkese per depozitim te dokumentave prane Regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane emerohet Z.ADRIAN DULAKU, i cili ka te drejte qe te beje dhe veprimet per depozitim e dokumentacionit prane asaj Gjykate.

SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk  
ORTAKU I VETEM  
SHOQERIAS "NEW PARADISE INTERNATIONAL" shpk